

H. Kajana ku

VITI I VII.

— MAJ 1936 —

Nr. 5

NORMALISTI

Jo në dijën, por në vullnetin
e fortë qëndron
vlëra e njeriut.

HERBART.

Drejtimi:
E përkohëshmeja "NORMALISTI,"
Shkollë Normale
Elbasan.

Shtypshkronja "SAIDE," Elbasan
1936

NDYL
DANAKU

Normalisti

E përkohëshme pedagogjike, letrare, shkencore
DEL NË FUND TË ÇDO MUAJI.

E botojnë nxënësit e Normales.

Editor : Harilla Kuçuli '37.

Sekretar : Hysejn Hashorva '37.

Arkëtar : Jovan Gjeitga '37.

Ndihmësit

Polikron Niçe '38.

Panajot Foto '38.

Elami Nimani '39.

**Pajtimi : për gjashtë numra 1 Fr. ari
Nji numër kushton 1 Lekë.**

Dorëshkrimet nuk kthehen.

Reforma Shkollore

Kur po përpiqesh flamurtari i math i dashunis nje-rëzore, para 100 e ca vjetsh, me e hap udhën për një edukatë popullore, u-konsiderue si një revolucionar dhe reformator. Mbas 50 vjetsh e në vitin 1863 pedagogu Teiler në Leipsi, në mësimin e tij fillimtar, zgjodhi për temë: **“Prirjet reformatore të kohës s’ onë n’Ar-sim”**. Sot mbas njëj periudhe të gjatë bâhet prap fjalë për një reformë mbrenda në shkollën fillore.

Për ç’ farë vallë do të flasin prap, kush e din mbas sa vjetësh? Pa t’jetër për reformë shkollore. Nevojat dhe prirjet edukative shkojnë kurdoherë dora-doras me përparimet shoqënore e ekonomike të jetës. Prandaj reformat arsimore janë pasonja të natyrshme të zhvillimit shoqner, një fenomen fiziologjik e medje i nevojshëm.

Britma **“ Shkollia ka nevojë për qetësi ”**, është helm. Ai që e mban këtë avaz do të thotë se nuk e kupton epoken dhe as nuk mundet me e ndjekë. Ai e damton direkt shkollën, pse shumë herë e pasojnë dhe shumë të tjerë, që e gjejnë parimin e ’tij t’ arsyeshëm, simbas mendimit të tyre natyrisht. Nga kjo pikëpamje reforma shkollore shfaqet ndryshe nga sa e karakterizojnë disa.

Nuk është e vërtetë se arsyeja e vetme e reformës është se bota nuk mbetet e kënaqun me përfundimet që jep sot shkolla. Ë drejta është se shumë reformatore gabohen, tue konsiderue të dorës së dytë përfundimet e sâkollës së sotshme. Duhet të pranojmë të gjithë se veprat kolosale të përparimit të sotshëm, bazohen në punën lodhëse të shkollës së libravet, dhe se triumfi i arteve e i shkencave, nuk do t’vinte pa punën e shkollës fillore. Por mb’ anë tjetër është një gabim i math, kur prej

të përnjoftunit të pasonjavet që dha shkolla fillore nxjerrim përfundimin se shkolla mundet dhe të mbetet njashtu si është. Nuk duhet të harrojmë se përparimet në vëzhgimin e ligjëvet natyrore dhe përdorimi i fuqive fizike suellën jetën në ndryshime, të cilat nuk i përqafoi ende shkolla.

Puna dhe nevojat e shkollës sikurse i ven jeta në shkollë, nuk gjinden më në marrëveshje midis tyre. Kështu shpjegohet si sot planet reformatore janë më të gjalla e më të larme se sa çdo herë t'jetër. Kundërshtarët e reformës shkollore bëjnë dhe ata teprime, tue parashtrua shpifje fantastike : **Reforma nuk lufton edukimin intelektual, nuk don që të pakësojë gjykimin e fëmijës, nuk kërkon ta bëjë shkollën vend lojsh.** Ai që ngul këmbë në këto shpifje, gënjehet. Në se reforma kishte për qëllim pakësimin e edukimit intelektual, për me largue me të vërtetë punën serioze dhe t'i shpëtojë fëmijës nga lodhja e kapërcimit të vështirësive, atëhere natyrisht do t' ishte e padrejtë dhe vetvetiu do të merrte një udhë të shtrembët. Por nuk është ashtu siç thonë. Ajo për të cilën e shpërçmojnë reformën është qëllimi i saj : **Zhvillimi i gjithë fuqive të fëmijës deri në gradën, që e lejojnë predispozisjet e natyrsme të tij.** Reforma nuk don të përmbysi, të rrënojë, por të formojë, të rindertojë, të punojë si **mbas natyrës.** Reforma kërkon ta shkelë verbalizimën dhe të largojë nga shkolla çdo gjë të përjashtme; kërkon, jo natyrisht të shkëpusi dashurin e fëmijës nga dëshira për të mësuem, por përkundrazi ta përmbajë të pafjetun. Don natyrisht të forcojë përpjekjen mendore të fëmijës, por jo edhe të kërkojë prej tij gjëna përtej fuqisë së tij mendore. Don të krijojë një bres të gëzueshëm, të zot për punë e më tepër të fortë. Kërkon

veprimin në vend të fjalës, me fjalë të tjera pamvarsin me anë të vet-veprimit.

Reforma i përket më tepër methudhës se sa lëndës. Lânda mësimore në pikat e saj kryesore do të mbetet po ajo. Reforma pra i përket më tepër udhës për arritjen e qëllimit se sa qëllimit vetë. Kjo rrugë duhet të rregullohet në një të 'tillë mënyrë, që në caktimin e punës shkollore të merren para sysh fuqit fizike të fëmijes, dhe qëllimi i naltë t'i përgjigjet kërkesave të jetës së sotshme. Reforma pra nuk i përket veçanisht vetëm mësimi as nuk shpenzohet për hymjen e njëj mësimi të ri — të punës së dorës bije tjalâ. Reforma kërkon një ndryshim të përgjithëshëm t'edukatës trupore, t'edukatës etike dhe të sërviçjes mendore; kërkon sipër të gjithë këtyneve të realizojë barasin shoqënore, deri sa është e lejuem, sikurse mb'anë tjetër është dhe e drejtë, të kërkojë një gjâ të tillë. Prandaj reforma në fellsinë nuk na sjell asgjâ të re. Këthehet më tepër mbrapa, kah herojt e historis së pedagogjis, Gërmon idët e arta për edukatën dhe kulturën dhe i mbjell prap në kohën e tashme, porse kjo nuk duhet të bâhet me fjalë, është nevojë së fundi të vëhet në veprim.

Kjo do të thotë **Reformë shkollore** —.

Niko Gjini '31.

Përparimi moral i një populli vetëm atëhere shkon krahas me përparimin intelektual të 'tij, kur ky i fundit mbështetet mbi baza të shëndosha. Për këtë arsye një nga problemat shoqënore dhe shtetnore më të rëndësishme Na kemi konsiderue dhe konsiderojmë problemën e shkollës

ZOG I.

Prej diallogut të V. Nastos me inspektorin e 'tij.

Shënim: Dy vjet më parë u rrah çështja e "përdorimit të librit të këndimit", në faqet e së përkohëshmes s'onë. Sot, po kjo çështje, vjen të zgjojë edhe një herë interesimin e disa mësonjëseve. Në numurin e Marsit të "Normalistit", botuam një artikull me titullin: "Këndim i mirë Z. mësonjës. Në këtë Z.V.Nasto, tregonte dobit e përdorimit të fletoreve dhe revis-tave si tekst këndimi (me rast). Dy bashkëpunorë t' onë të vlefshëm vijnë në këte numër ta prekin edhe më këtë çështje: Z. S. Paparisto na dërgon nga Gjenera një artikull me të cilin përkrah mendimin e Nasto-s. Nga ana t'jetër Z. H. Ballshi nuk e pëlqen këtë methodë dhe na tregon të metat e 'saj. Po botojmë, njerin pas t'jetrit, këta dy artikuj, duke lënë të lirë lehtësin arësimitar të gjykonjë mbi arësytet e të dy anëvet. Na gëzohemi kur shohim se botimet t' ona shkaktojnë rrahje mendimesh,, në dobi t' Arsimit).

Në "Normalistin", e marsit të këtij viti pashë një artikull të Zotit Nasto me titullin "Këndim i mirë Zoti mësonjës", në të cilin ai shfaqte mendimin mbi lëndën që mësuesi mund të gjejë për të zavendësue librin e këndimit. Me këtë artikull Z. Nasto ka qëllue në një themë mjaft me rëndësi për shkollën përgjithënisht dhe ideja e bukur që ai na ep më duket se me-riton m'u-bisedue, m u-zhvillue pak më gjënë si edhe m'u-zbatue.

Unë në këto rrjeshta nuk kam ndër mend me bā gjā t' jetër, veçse me e zgjanue shumë a pak këte idë, e cila më duket me një rëndësi kryesore.

Qysh prej kohëvet më të lashta, qysh se është shpikë shkrimi e këndimi, ndër shkollat fillore nuk përdorej gjā t'jetër veçse ngjyrë, pendë e kartë; më vonë, me shpikjen e shtypshkronjës filloi m' u-përdorë edhe libri i këndimit. Qysh prej këtyne kohëve deri sot ndër ne po këto mjete përdoren, d. m. th. penda, karta e libri i këndimit (me përjashtime të pakta). Mirpo sa kanë ndryshue marrëdhëniet shoqënore deri atëhere ! Sa ndryshime ka bā shkenca e mentaliteti i shoqënis ç' prej asaj kohe deri sot ? Me gjithë këto ndryshime e përparime në shkencë e gjetiu, shkolla s' ka bā ndonji ndryshim të madh dhe veçanërisht shkolla e jonë, e cila, sikurse thamë përveç kartës, pendës e librit të këndimit s'ka futë në përdorim gjā t'jetër (me përjashtime të vogla).

T' i lāmë mbë një anë librat shkollorë, të cilat përmbajnë

lândë të kufizueme e të dalim në ngjarjet e shoqënis së sotëshme. Nxânësi rron sot e pra duhet ta rrisim me mjetet që na lejon koha e sotëshme e në shoqënin e sotëshme. Qëllimi i shkollës së ré nuk është me e përgatitë nxânësin për jetën (siç e mendojnë disa), por **me e bâ ate të rrojë**. Fëmija sado fëmi që është, prap se prap rron, është në jetë, nuk është në diçka t' jetër ku përgatitet për jetën. Pra vetëm tuj e bâ fëmin me rrue, due me thënë me e përçue që të dijë me rrue qysh se është fëmi, vetëm në këte mënyrë e përgatisim ate për jetën e fëminis e ai që është i përgatitun për këte, natyrisht përgatitet vetëvetiu për jetën e mâpastajme (t' adytlit). Kështu e ka kuptue qëllimin e shkollës Decroly tuj u-bazue në parimin e 'tij : **Shkolla për jetën, me anë të jetës**. Po kështu mendon edhe Claparède-i kur thot **se shkolla është jetë**.

Një mësues pra që ecën mbas këtyne parimeve nuk mbahet vetëm me librin e këndimit, por kërkon e vëzhgon në jetët gjithëshka (libra, gazeta, revista, gojëdhana, dokumenta, fotografija etj) që ka lidhje me nevojat e nxânësit, sikurse e thot edhe Z. Nasto n' artikullin e bukur të 'tij. Jo vetëm në mësimin e historis e të moralit mund të gjejmë sende të vlefshëme për shkollën, por edhe në çdo lândë t' jetër. Për gjeografi p. sh. mund të gjejmë përshkrime vendesh, ngjarje të ndryshëme ndër shkretinat, buzë deti etj. Për shkenca po s' është nevoja me e përmendë lândën e shumtë që mund të gjejë njeriu për t' i shërbye shkollës. Për matematikë mund të gjejmë llogari bankash e shoqënish, mund të nxjerrim me mijëra problema nga industria e nga bujqësija, nga jeta e vendit ku gjindemi, d m. th. nga jeta e njimendët, me fjalë të tjera nuk ka lândë mësimi, së cilës nuk mund t' i shërbejë jeta praktike e botimet e ndryshëme.

Mirpo po të kërkojmë gjithë këto gjana prej mësuesit largohemi vetë nga jeta dhe kërkojmë gjana të pamundëshme, bâhemi tepër teorikë e pra pa ndonjë vlerë praktike, sikurse moralistët tepër idealistë, të cilët, tue mos shikue se ku gjinden, kanë predikue një moral aq ideal e të papajtueshëm me jetën praktike, saqë në vend që të sillnin dobi, nuk kanë sjellë veçse dëshprim e kritika.

Pra gjithë këto lândë praktike (jasht tekstevet shkollore) a duhet t' i mbëledhi mësuesi ? Si mbas Zotit Nasto e inspektorit të 'tij, po. **Shembulli që na ep Z. Nasto na tregon se mësuesi**

e ka gjetë lëndën vetë dhe u a ka këndue nxânësvet. Kjo mënyrë veprimi nuk është e keqe, vetëm se më duket se do t' ishte shumë më mirë sikur këte lëndë ta kishin gjetë vetë nxânësit, ta kishte këndue njeni prej 'tyne e ta kishin spieguë e bisedue vetë ata. Në këte mënyrë nxânësi vepron e mësohet me kërkue e me zbulue dhe më në fund me përfitue prej këtyne zbulimeve. Kështu më duket se i afrohem i parimit të bukur të Spencer-it : **“ me mësue sa më pak që të jetë e mundun, me bënë me gjetë sa më shumë që të jetë e mundun ”.**

Me të gjitha këto due me thënë se përmbledhja e lëndës së përshkrueme më sipër nuk i përket vetëm mësuesit, por më tepër nxânësvet.

Po a mund të lëmë ndër duer të nxânësvet revista e gazeta të ndryshëme ? A nuk përmbajnë këto gjana që fëmija nuk i kupton e që nga një herë janë edhe të rrezikëshme për shpirtin e fëmis ? Kështu mund të thonë disa. Asht shumë e vërtetë se gazetat e rivistat shumë herë përmbajnë lëndë të rrezikshëme jo vetëm për fëmin, por edhe për të mëdhenjt, ose, në qoftë e rrezikshëme lënda në cilësi, është e rrezikshëme mënyra e të kënduemit të 'saj. Mirpo a ka kohë më të bukur se moshë e fëminis (15-16 vjeç) e më vend të bukur se familja e shkolla, ku fëmija është në përpjekje më shumë se kurrë me shokë, mësuesë e prindë, a ka më rast të volitshëm se ky për ta përçue nxânësin me dijtë me zgjedhë lëndën e gazetës e të rivistës dhe me nxânë si me përfitue prej këtyneve ? Janë shumë të mëdhenj, që, kur u bje ndonji gazetë ndër duer, humbin nëpër shpalljet ose lajmet kriminele, mbassi këto nuk kërkujnë ndonji disiplinë mendore. A nuk mund ta përmirësonte këte të metë edukata e fëminis ?

Nxânësi, tuj ranë mbas gazetash e rivistash, humb kohë e mbet mbrapa ndër mësime, mund të thonë disa të tjerë.

Në qoftë se edukatorët do të dijnë me e përçue fëmin në këndimin e duhur, të jemi të sigurtë se ajo (fëmija) nuk humb kohë, por fiton, fiton dy fish kohë : fiton kohë e zhvillohet në moshën e fëminis, gjë e cila do ta përçojë të fitojë edhe më shumë kohë në moshën e madhe (adytl).

Lënda e tillë, që mund t' i shërbejë shkollës, nuk përmbledhet vetëm prej rivistash e gazetash. Nxânësit mund të shkruajnë vetë mbi : një ngjarje që kanë pa rrugës, një udhëtim që kanë

bâ (përskrim) në malsi, buzë deti etj. një gojdhënë që ndokush u ka tregue; një grup nxânësish mund të marri përsipër një studim mbi një sëmundje popullore, mund të pyesin ata vetë mjekun, mund të këndojnë ndonji libër e të bëjnë një raport (e një konferencë) mbi këtë studim; një grup t'jetër mund të bëjë një studim mbi historin e një vendi, një t'jetër mbi bujqësin, projekte, plane etj. Kështu veprohet në shkollën e Collings (n' Amerikë), të Geheebe (më parë në Gjermani e tash në Svicër) etj.

Këto dokumenta të përmbledhuna prej nxânësve jo vetëm që i shtojnë këta në kërkime të vijueshme, por janë edhe një dokument i vlefshëm për shkollën. Kështu veprohet në shkollën e ré, në shkollën e punës. Mos të kujtojmë se këto shkolla përmbajnë diçka misterioze, jo; parimi i 'tyne është shumë i thjeshtë : **me veprue, me jetue**. Çdo mësues mund t' i njëmendësojë shumë a pak parimet e shkollës së ré. Metoda nuk ka ndonji rëndësi të madhe. Pedagogë të ndryshëm kanë shpikë me qindra metoda, por qëllimi është po një.

Nga sa thamë kuptohet se shkolla me anë të punës së nxânësve e ndihmës së mësuesve mund të formojë një lëndë të bukur, një kapital të mirë, që smadhohet çdo ditë e që i vlen asaj në shumë raste. Por ky kapital duhet rregullue, duhet rëndue në mënyrë që nxânësit e mësuesit të munden me e gjetë lehtë atë që do të kërkojnë një ditë, kur do të kenë nevojë. Nuk duhet ta mohojnë se një punë e tillë nuk është edhe aq e lehtë. Pedagogë të ndryshëm janë marrë me punën e rendimit të këtyre dokumentave shkollorë. Një nga më të shquemit është pedagogu praktik Freinet, i cili me anë t' organit të tij : "**L' Edukateur prolétarien**," s'pushon së dhânuni njohni mbi atë që ai e quën "**fichier scolaire**," e që në shqipet s' po gjëjë fjalë më të përshtatëshme se "**thesari shkollor**,"¹⁾ si edhe mbi shtypshkronjën në shkollë, dy vepra me rëndësi të shkollës së ré, të shpikuna e të njëmendësueine prej këtij autori : Freinet bashkë me mikun e tij Frallemant ka hartue një broshurë : "**Pour tous classer**," ku na tregon hollësisht mënyrën e rendimit t' atij që unë e quejta thesari shkollor, si edhe të

¹⁾ I lutem gllisollogëvet t' onë, po të gjejnë një fjalë më të përshtatëshme, t' më lajmërojnë.

bibliotekës së mësuesit.

Ja një shembull :

Puna shkollore është nda në 10 paragrafe të rendueme kështu :

- | | |
|--------------------|-----------------------------------|
| 0 — Studim | 6 — Njehsim e shkenca |
| 1 — Sjellja e jonë | 7 — Punë e prodhim |
| 2 — Histori | 8 — Puna (aktiviteti) njerëzore |
| 3 — Gjeografi | 9 — Studim e administrim |
| 4 — Natyrë | |
| 5 — Libra e arte | |

Çdo numur nga këto është nda në 10 paragrafe të tjerë e seicili prej këtyneve gjithashtu po në 10 të tjerë. Këtu nuk mund të tregojmë përmbajtjen e njëj libri, vetëm po apim një idé të përgjithëshme mbi të renditunit e dokumentavet shkollore. Qëllimi i këtij rendimi është që nxënësi të munda të gjejë shumë shpejt një dokument që kërkon ndër një mij të tjerë.

Kështu nxënësi mund të presi artikuj, fotografija etj. prej rivistash, gazetash, ose më mirë mund t' i kopjojë këto e mba sandaj i rendit simbas natyrës së 'tyne. Po kështu vepron edhe për studimet e dokumentat e tjera.

E shof se ideja që formon themën e këtij artikulli nuk është zhvillue sa duhet, por shpresoj se të tjerë do të kenë mirësin me e zgjanue këte idé edhe më tepër. Tash për tash nuk kam veçse me e përgëzue Z. Nasto për themën e bukur që na zbuloi, si edhe inspektorin e 'tij të dashtun, që ka dashtë ta zâjë si Nastradinin në prast Naston e gjojë.

S. Paparisto

Mbi nevojën e librit të këndimit

II.

Dy vjetë më parë shoku i im, Vangjel Nastua, ngulte këmbë për flakjen e librit të këndimit, mbassi nuk bën pjesë në botën e qytetruar. Vëndin e 'tij ta zënë librat, fletoret, të përkohshmet Kështu thoshte ai.

— Jo, ne s' kemi as fletore, as të përkohshme, as libra për ta bërë këtë punë. Kur të kemi këto, atëhere munt ta flakim librin e këndimit. Kështu thoshja unë.

Kaqë qe e shkuara.

Tashti përdorja e njëj fletoreje si tekst këndimi në një orë

të caktuar i paska prurë Nastos lavdërimin e inspektorit. Dhe, duke përfitur nga ky rast, gjën shkak të këthehet edhe një herë në polemikën t'onë **“mbi nevojën ose jo të librit të këndimit,**.. Këtë radhë flet më shumë inspektori se sa Nastua; ai e lavdëron punën e 'tij e kritikon ata mësonjës, që nga mungesë aktiviteti ngrënë zërin përpjetë e thonë: s'kemi libra, fletore, të përkohshme e tjera. Mësonjësi aktiv i mbleth, i ruan e pra pasurohet me këto. Nuk di në se kam të bënj me një inspektor fandazije, të krijuar nga shoku i im, për t'i dhënë përgjigjen e duhur. Por, cilido qoftë, do t'i përgjigjen: Jo zotni, librat, fletoret të përkohshmet e çdo sent tjetër i mbleth dhe i ruanj si syt e ballit; kam formuar edhe unë bibliotekën t'ime. E di mirë se biblioteka është thesari m'i math për çdo mësonjës. Kështu besoj ta çmojnë të gjithë. Prandaj në këtë çështje s'duhet të këtë mungesë aktiviteti. Edhe në ka, është këtu, këtijë. E vërteta e vërtetë është mungesa e librave. Nga kjo e vetëm nga kjo nuk munt të flaket libri i këndimit.

Do të më thoni se e flakim pjesërisht. Po, e pranoj këtë vetëm me dy kondita: 1.) të mos për dorim fletore: 2) të shpërndajmë aqë kopje të copës sa nxënës kemi. E para, d. m. th. përdorimi i fletoreve është i dëmshëm, sepse stili i 'tyre nuk i pershtatet mëndjes së njomë të nxënësve. Veç kësaj këtu ndër ne përdorimi i fletoreve ka edhe një helëm tjetër: **fjalët e huaja**. E dyta, d. m. th. sasija e kopjeve të copës duhet të jetë në përpjestim me numrin e nxënësve, sepse pa këtë nuk mbahet vëmëndja dhe nuk fitohen njohnit orthografike. Si për rastin e parë, ashtu edhe për të dytin nuk më flet natyra, por prova. Herë pas here e në raste të volitshëm e kam lenë edhe unë më nj' anë librin e këndimit. Ja se si.

Një ditë arrita në histori (klas' e IV^{te}) në vitin 1914. Flas për Widin, për Esatin, për rrebelët dhe për vrasjen e katër patriotve në Berat N' orën e këndimit për koncentrasion gjeta ne të përkohshmen përparimi, që delte n' Amerikë një shkrim për Is-

**I pari ligj i moralit të vërtetë është: “ E d u k o v e t - v e h t e n . , dhe pastaj vjen i dyti: “ I n f l u e n c o t ë t j e r ë t m e p e r s o n a l i t e t i n t ' ë n d ,
Wilhelm von Humbold**

mail Klosin, i cili është një prej dëshmorve të Beratit. Këtu në të thënit e mbrendis dhe në këndimin e mësonjësit sigurova interesin më të math; përkundrazi në shpjegimin e fjalëve gjeta belan më të madhe: Ndodheshin fjalët hallusinasjon, konsolidim e tjera. Hajde tashti t'iu shpjegojë nxënësve edhe pak psikologji e frëngjisht!

Një herë tjetër n'edukatë morale kishja zhvilluar:

“Përpjekjet e patriotve dhe vuajtjet e tyre për lirin e Shqiprisë.” N'orën e këndimit gjeta në fletoren **“Bashkimi Kombëtar”**, që nxirresh prej Fehim Zavalanit më 1910 internimin e Dervish Himës, i cili, siç më duket, shkruante me pseudonimin Kanani në fletoren **“Tomorri”**, të Zotit Lef Nosit. Ketë e përdora. Interesi i nxënësve në fillim qe në kulëm: mirpo, si mbaroi këndimi dhe shpjegimi i mësonjësit e nisi këndimin ndonjë nxënës, atëhere nxënësit e tjerë filluan të hapin gojën, S'i vinin veshin, mbassi u shterua interesi. Ajo që e bën nxënësin t'i mbaj syt dhe mëndjen në këndim është frika se mos mësonjësi thotë: **lëre ti, fillo ti t'jetri**. Me këtë mënyrë sigurohet jo vetëm vëmëndja, por përfitohet edhe nga ortografija e copës. Po kur kemi vetëm një fletore ose një të përkohshme a mut të bëhët kjo?

Prapë një herë t'jetër n'edukatë morale zhvillova mësimin **“mirbërsija”**. Ato ditë shpirtmiri Thoma Turtull i kishte falur Shtetit shumën e madhe për Liceun e Korçës. N'orën e këndimit përdora artikullin e faqes së parë të **“Besës”**, që ia dedikonte e këtij. Këtu përpoqa më një pengim të math, **në mos kuptim**: ishte stil i rëndë për nxënësit e mi. Prandaj përdore në daç gazetën!



Nga mos pasja përfundim të mirë n'orët e sipërme, u-mundova të gjejë rrugën e drejtë për një këndim të mirë. Dhe e gjeta: Kishja zhvilluar një ditë në histori natyre **arin**. Përpara se të vinjë orë e këndimit këtheva prej poezije në prozë nga shkëndija e Zotit Kristo Floqit vllazërimin, që bëri një herë një njeri me një ari. Pastaj shtypa në maqinë aqë kopje sa nxënës kishja: N'orën e këndimit mora një kopje, kallzova mbrendin, kendova dhe pastaj shpjegoja. Me në funt u shpërndaj nxënësve nga një. Ç' të shihje?! Plot vëmëndje, interes, gjallëri ishte e gjithë klasa. Filloi dhe mbaroi ora në gëzim e fytyrëçelur.

Atë ditë pash këndimin e vërtet; këndimin që bën bota e huaj; këndimin që kërkon me kembë-ngulje shoku im, Vangjel Nastua.

Mirëpo cilit mësonjës i tepron koha të kopjonjë prej një fletoreje a të përkohëshmeje aqë kopje sa nxënës ka klasa e tij? Cili e bën këtë punë rregullisht le të thotë e le të na tregojë mënyrën se si. Po s' u-bë kështu, atëhere fletorja, e përkohshmeja e libra nuk duhet të përdoret. Në u përdorët, do të ketë më shumë të meta, se sa të mira nga libri i këndimit që është në fuqi.

Nga ky shkak them : Jo edhe aqë i mirë këndimi i Nastos Zoti inspektor.

Haki Ballshi

Gjurmat e kohës.

Kontrastet e Arësimit.

II.

Mbas dhietë vjet mësonjës in U. e transferuan nga ai fshat, jo për pazotësi, por për gradim, se katundarët e donin shumë. Dhe . . . kur të don populli i padjallëzuar, pse ti han e dehesh bashkë me 'ta, do të thotë se ti ke zotësi për t' i bërë për vehte katundarët!! . . . Vëndin e mësonjës it të parë e zuri një mësonjës i porsa dalur nga bangat e shkollës. Ai ishte i ri, punëtor, i zoti dhe kurdoherë ishte në përpjekje me përparimet pedagogjike, letrare e shkencore. Rivistat pedagogjike, si " Mësuesi „ „ Edukata e Re „, që i dërgoheshin padashur mësonjës it U., mësonjës i ri i gjeti grumbull dhe fare të paçflefatosura : ashtu si impostoheshin nga zyra e redaksisë, ashtu përplaseshin mbi dritare nga zoti U. Mësonjës i ri habitej me vetvehten për painteresimin e për kërshërin e vdekur të mësonjës it U. Por si do qoftë rivistat mbanin erë myku dhe pluhur me okë!!.

Një shpirt plot zjarr, një mendje në lëvrim të parreshtur si kjo e mësonjës it N. nuk mund të pajtohej kurse si me gjendjen e shkollës. Mbas një jave, që nga fillimi i detyrës së 'tij, thirri kryepleqësinë dhe e këshillon, që t' i zmadhojnë dritaret e derën, t' i bëjnë dhomës një tavan, t' i ndreqin bangot më mirë edhe t' i lyejnë muret me gëlqere. Këto gjëra i kërkoi dyke vënë përpara shëndetin e nxënësve, të mirën e fëmijëve të fshatit. Kryepleqësija tundi kokën, vuri buzën në gas dhe iku pa i dhënë as një përgjigje mësonjës it të ri, edhe në kafenen e fshatit

pëshpëritnin njeri me tjetrin :

— Edhe ky kërkon të na shesi mënd : bën gjoja sikur i vjen keq për fëmijët t' onë. Pun' e madhe se janë dritaret të vogla, pun' e madhe se s' paska shkolla tavan e se s' qenkan lyer muret ? ? Ah, zoti U. ku je ! Ti ishnje i zoti për mësonjës, pa këtë ligavec, që na e dërguan tani, ler-e mos e ngà ! !

Mbas 3-4 ditëve mësonjësi i thërret përsëri; këtë herë i vajti vetëm kryeplaku. Ai tha se fshati nuk mund të shpenzonte para për qejfin e mësonjësit. Mësonjësi U. nuk ishte budalla, që ndejti dhietë vjet në këtë shkollë pa na kërkuar asgjë. — Mandej si me ironi shton : — Zotrote je djalkë akoma. Ai ishte burrë, kishte 15 vjet mësonjës e kishte bërë një shkollë shumë të madhe. Ti nuk e din se sa i zoti ishte : bëj hesap që as një herë mbrenda dhietë vjetëve nuk e mundi njeri në letrat dhe as që ia kalonte njeri në të pirë e në valle. Të thashë ti je akoma djalkë e me një kupkë mund të dehesh ! Prit një herë sa të mësohesh e pastaj fjalosemi bashkë.

Kryeplaku fliste e mësonjësi dëgjonte duke i ardhur keq për arsyetimet fare pa vënd të katundarëvet. Por . . . duhet të dëgjonte e . . . mandej i u-përgjegj :

— Dyke menduar shpenzimet, që do të bëni për ndreqjen e shkollës, ju kini të drejtë të kundërshtoni, mirpo shëkoni një herë shëndetin e fëmijëve t' uaj : janë fare të zbetë, të pafuqishëm, të qullët e fytyrë-vrerët; bile edhe djali i juaj, siç e shëkoni, dita-ditës po dobësohet e po . . . sëmuret. Nga se vjen kjo ? Eshtë afër mëndjes se kjo shkaktohet nga se dhoma e klasës është fare e papërshtatëshme për [60] nxënës : ajo është e vogël, pa dritë edhe fare e papastër. Ju po ta ndreqni shkollën nuk do ta bëni pse dua unë, por do ta ndreqni pse ashtu e don e mira e fëmijëve t' uaj. Për ndryshe fëmijët e juaj ju vetë si prindër për tërë jetën do t' i dënoni të jenë të zbetë, të pafuqishëm e të sëmurë.

Kështu i fliste mësonjësi përfaqësonjësit të fshatit, por atij nuk i u-mbush koka — Ler-i, mos na i shit ato pallavra ! — ia bëri. — Mësonjësi U. nuk ishte budalla ! — dhe iku përsëri pa ia varur veshin mësonjësit. Puna u-kuptua : Mësonjësi U. kishte lënë gjurma të thella prapanike aqë sa katundarët besonin me kokë fortësi në veprimet e 'tij. Por i Riu nuk dëshpërohej : së pari u tha katundarëve se atë e paguante shteti fare mirë, prandaj

ushqimin të mos i sillnin nxënësit; as dhuratat e ndryshme nuk i donte, mbassi me rrogën i kishte blerë të gjitha. Ketë vendim katundarët e kishin pëlqyer shumë. Mirpo e mira u-harrua, se katundarët panë edhe ndryshime të tjera, që nuk i pëlqenin aspak: P. sh. në programin e mësimeve vuri gjimnastikë, punë-dore, vizatim, lodra, shëtitje edhe punë bujqësore. Për këto fshati i tërë u-çqetësua: Ku është parë — pyetnin vehten — që një mësonjës të luajë bashkë me nxënësit, të bëjë lulka edhe shëtitje? Pastaj ç' taksirat që të punojnë nxënësit me kazmë? Se mos nuk mjafton që punojmë neve?! — Por katundarët i çqetësoi edhe një gjë tjetër: rrugëve nxënësit shkonin plot gas dhe kur u afrohej mësonjësi, në vënd që të iknin me të katra si bënin nga mësonjësi U., përkundrazi grumbulloheshin rreth mësonjësit dhe bisedonin e qeshnin së bashku me të. — Ç' janë këto budallëllëke? — thrisnin katundarët — Le që nuk mësojnë tani, por as frikën nuk na e kanë, kur u kujtojmë mësonjësin!

Dhe . . . kishin të drejtë: Mësonjësin U. nxënësit e nderonin nga frika, kurse këtë e nderonin pse ashtu dëshëronin. Pastaj në kohën e mësonjësit U. nxënësit rinin orë të tëra të krusur mbi vatër për të mësuar një faqe të librit ose një problemë arithmetike fare-fare përmëndësh; kurse tani me mësonjësin e ri çdo gjë e mësonin në shkollë me kuptim, dhe të gjithë nxënësit ishin të zotët. Në shtëpi bënin ndonjë ushtrim të vogël, që nuk donte veç disa minuta për t' u-kryer. Mirpo . . . për katundarët, që nuk i shikonin më nxënësit të krusur orë të tërë mbi copën e këndimit dyke u-dridhur edhe nga frika e purtekës, mësonjësi i ri nuk bënte aspak punë!

— Ç' farë mësonjës është ky — pëshpëritnin pleqtë — që nuk i a shtron një herë në kafene me nga ndonjë kupkë raki? Eh, vetëm një mësonjës pati fshati, zotin U., . . . e hë, hë se na vjen tjetër si ky!! — shtonin me mallëngjim miqt' e rakisë!

Me gjithë këto kundërshtime i riu nuk ndalej së punuari: kudo këshillonte, kudo punonte dhe kurdohërë përpiquej të ipte shëmbëllën e mirë. Kishte besim të patundur në vet-vehten: besonte se një ditë kokë-fortësin e fshatarëve do ta këthente n' arsyetime me vënd. Hë për hë kënaqej me dashurin e pastër të nxënësve të 'tij

St Spasë.

Evoluzioni i shkollës Çineze (1)

Dhet vjet më parë shkolla, në Çinë, ndiqte sistemin e vjetër. Mësuesit mësojshin, në dhoma t'errta e të ndyeta, një grupbull fëmijsh që, të mbërthyem për mjaft kohë në banka të nalta, ndëgjojshin spjegimin e shkrimevet të çuditëshme. Mandej, në një kor të zëshëm e të fortë, këta fëmij kendojshin shkrimin a këndimin e 'tyne, që të mund t'i rranjosesh më mirë në tru, kurse mësuesi, i ulun përpara tavolinës, ndëgjonte, tue tymosun ose tue thithun çaj. Shpesh flinte dhe kur zgjohesh, përplaste me zemrim dajakun e vet, për me goditun gabimin nxansat e korit monoton.

Vajzat mbeteshin analfabete; vetëm shumë rrallë, ndonjij grueje pasanike e fisnike, i mësohesh privatisht prej mësuesish.

Tash është krejt ndryshe: mësimi, nuk ka shumë kohë, është i detyrshëm, dhomat shkollore mbahen të bukura, të pastërta e të ajrosuna mirë, edhe në qendrën e Çinës. Mësimet mesohen prej mësuesish të diplomuem, në klasë të ndame dhe të organizueme mirë dhe ndjekin një orar.

Landët që mësohen janë pak a shumë si t'onat. Nxehtësit e klasës së katër dinë të thonë se Ballkani është një gadishull.

E nuk është pak për një popull, që deri në kohnat e fundit ishte krejt ndryshe e që nuk lejonte as një Europjanm e shkelë në tokat e veta. Tash nuk është më ashtu. Njerëz, sende, mjete e maqina europiane gjinden e përdoren kudo.

Në dhomat shkollore përdoren mjete të ndryshme moderne, krejt çineze, të bame si mbas sistemavet europiane.

Metoda e mëimit është pak e ndryshme. Shkollat e vërteta e të mira Normale, janë të pakta: katër a pesë në gjithë atë shtet të gjanë dhe sa për punën, nuk punojnë pak. Këta farë mësuesish, që e kanë pamë të paktën një libër Didaktike, apin punë të mirë në atë shkollë, ku drejtori është njeri me ndërgjegje.

Për arithmetikën përdorin, qysh në klasët fillimtare, shifrat arabe. E nuk është për t'u thanë se sa është tërëhjekëse me hy në një klasë, tue shkruem mbi karta të holla (me një pupël të mbajtur përrpendikolar) shenja të çuditëshme, që për ata janë

(1) Marrë nga revista "Scuola Italiana Moderna,."

plot kuptim.

Për vështirsinë e mësimit (në këndim e shkrim) një klasë e pestë çineze, barazohet me një të tretë europiane.

Krejt një gjë e çuditëshme është për ne edhe puna se, qysh në klasët e para, mësimi zgjat 50 minuta e me mesues të ndryshëm, kështu që në një ditë, në një klasë hyjnë 3 a 4 mësues, sikurse në shkollat t'ona të mesme.

Përkthim: Gavril Santo '33.

Lëvizje edukative.

Gjenevë.

Më 25 Prill profesori Pierre Bovet u mbajti një konferencë nxënësve t' Institutit Rousseau. Në këtë konferencë Z. Bovet foli mbi udhëtimin e tij gjatë pushimeve të Pashkëve në Hollandë, Francë, Palestinë etj., mbi institutet edukative që kishte vizitue ndër këto vende, mbi kongresin e Hollandës, ku më se 500 pedagogë kanë bisedue mbi themën; **"Si me i mësue nxënësit me jetë së bashku,"** dhe mbi pedagogun Hollandez Kees Bock, metoda e të cilit është sa e ré aqë edhe interesante. Në shkollën e Kees Bocku-t zbatohet një farë **"Self-government-i,"** original e i ndryshëm nga ai i Amerikës.

Më 30 Prill Z. Bovet mbajti një konferencë t' jetër në sallën e Universitetit për popullin e Gjenevës. Thema që: **"Freud i, jeta dhe vepra e tij,"**

Më 5 Maj psikologu i mirënjohun Polonez Balais mbajti një konferencë në sallën e Institutit Rousseau, ku foli mbi kërkimet që është tuj bërë mbi **grykimin esthetik të fëmijë. Z. Balais** foli më tepër mbi të mirat e **metodës klinike** që ai ka përdorë në këtë kërkim, metodë e cila, e krijueme dhe e zhvillueme prej Piaget-it, sot po përhapet në të gjithë botën psikologjike.

Zyra Ndërkombëtare e Edukatës i drejtoi Ministrivet t' Arsimit të shteteve të ndryshme një anketë mbi **"arsimin ndër katundet,"**. Pyetjet përmbledhen në 12 pika, në 4 kapitula: **Organizimi shkolluer, programa e metoda, personeli mësimeur, vepra për edukatën ndër katunde.**

Greqi.

Pranë Ministris s' Arsimit është krijuë zyra e sinematografis

edukative. Nji Zonjë, Kryetare e Këshillit të gravet greke, ash emnue drejtoreshë,

Kinë.

Ministri i Arsimit ndaloi përdorimin e stilovet. " Fërrçet pikturuse (në formë pende), që janë përdorë qysh prej shekujsh, i japin shkrimit Kines një formë me të vërtetë artistike „ thotë Z. Ministri.

Këndimet-e mija-dhe vlera e 'tyre.

Unë jam nga ata për të cilët të njohurit e një libri munt të bëhet një ngjarje morali e vërtetë. Pakica e pjesëvet të mira këndimi, prej të cilavet jam përshkruar qysh se kur roj, ka shvilluar këto të paka cilësi të mira që kam. Nukë e di ç'far do të kishin prodhuar këndime të këqia; unë nga ata nukë kam kënduar aspak, duke pasur fatin të udhëhiqem mirë që prej fëminis. Nukë më mbeten pra veçse kujtime të ëmbël dhe të dashur.

Oh! cili është ay që nuk kujtohet me dashuri për pjesat e para, që ka kënduar me qef e q'u ka shijuar fitimin? Cili është ay, i cili në këndimet, që ka bërë, ka ndërë një mërztitje a pakënaqësi ose nonjë dëm moral? Besoj, që seicili, në ato pakë pjesë, që ka kënduar, ka përfituar diçka, duke mos u-dëmtuar aspak.

Me anë të këndimit shtohet përgjithësisht dija e njeriut; kjo dijë munt të jetë e përgjithëshme dhe duhet të dimë ta përdorim. Duke qënë të udhëhequr, që në fëmini, me një mbikqyrës të palodhur, për të na mësuar vleftën e së mirës dhe dëmin e së keqes, kur të jemi në moshë që munt të veprojmë ose për mirë ose për keq, do të dimë të largohemi prej sendevet të këqia, prej atyre sendeve imorale që e rrëzojnë poshtë dinjitetin e njeriut dhe do të mundim t'a lartësojmë këtë prej mësimevet të mira të librit.

Një libër ka qënë gjithënjë dhe është për mua një mik, një këshillonjës, një ngushëllonjës i prekshëm e i qetë, prej të

Na nuk dijmë as një-të-njëmiljontën e gjërave, që duhet të dijmë.

THOMAS EDISION

cilit unë nukë dua të ndahem e t'i pres shpejt burimet e diturisë s'eme, të cilat i ruanj për rastet e mbëdha.

Për një njeri, i cili ka llogjikë, vepron me arësye dhe jo pa u menduar, këndimi është këshillonjës a udhëheqës në punë të mira; por për të tjerë mund të jetë udhëheqës në punë të këqja dhe miku i këtyre të fundit; mbassi në këndimet gjejmë të përshkruara pjesë të ndryshme: novela, romanca të ndryshme pa farë dobie, fantazira dhe endërrime njerzish fatkëqij, kallzime aventurash e aventurierësh të ndryshme etj. etj. . . . , të cilat po t'i besosh a t'i imitosh nukë e di se ç'farë përfundimi kishin për të dhënë: do të mirje vehten më qafë si edhe të gjitha ata që të binden e të shoqërojnë; përkundrazi pjesa këndimi njerzish të mbëdhej menderisht, që shkruajnë shumë bukui jetën e 'tyre, pjesa historie, literaturë, pjesa morali e të tjera si këto, është mirë t'i këndosh, duke i arësytuar, sepse të frymëzojnë për jetën t'onë të përditshme, për të kryer punë të mbara.

Provoj në vehten t'ime se çdo këndim, që kam bërë, ka pasur një vlerë të madhe për mua: më ka dhënë njohni të nevojshme e pak a shumë të mjaftushme, duke qënë se mundohesha dhe mundohem gjithnjë të mos gjej libër, që të ketë pjesë të ndërlikuara, të kota a imorale.

Sot gjithë dijnë të këndojnë, por këndojnë ç' u vjen mbas dore, vetëm me qëllim që si e si të thonë se unë kam kënduar këtë e atë libër. A ka nonjë vlerë ai këndim i 'tyre? S'dihet!

Njeriu në jetë ka nevojë për miq, që t'i jenë miq jo vetëm kur të jetë mirë në ç'do pikpamje, por edhe kur ky të bjerë në ngushticë. Fatkeqësisht kjo gjë nukë ngjet sepse miqt i afrohen njeriut vetë kur ky s'u ka nevojën; kur ky të bjerë një herë në të keqe të gjithë miqtë do të largohen e do t'i tregohen edhe si armiq. Kjo më ka ngjarë dhe mua. Unë munt të them se kam shumë miq, por a i kam miq për kokë s'e di. Mbas provash, që kam bërë, kam venë re se asnjeri nukë është mik për kokë, veç disave; shumica e 'tyre janë miq për fiq.

Një ndër miqtë, që më ka qëndruar besnik dhe do të më qëndrojë, me të vërtetë dhe pa interes, janë copat e këndimit, të cilat më ndihmojnë gjithnjë me ç'do mënyrë si moralisht, ashtu dhe materialisht.

Nukë dua të zgjatem tepër; por sikurse kam parë dhe shoh, dua që çdo këndonjës të mundohet me çdo mënyrë që t'i rrë-

njosë në mendjen e 'tij ato copa këndimi, që munt t'i vlejné si këshilla a si thesarë njohnish për jetën e 'tij dhe t'u hapi rrugën atyre, të cilat nuk munt t'i jenë të nevojshme, dhe dëmin e të cilavet do ta kuptoj mbassi t' i ketë larguar. Edhe këndimi ka të bej sido kudo me fjalën: "thuam me kë rri (ç'këndon) të të them se cili je.."

Me qënë se jini akoma të rinj, veproni si është e arësyeshme dhe e njerzishme, sepse djemtë e rinj janë si ay hekur i nxehtë, i cili nga t' i bie sh me çekan drejtohet.

Mbassi ta provoni do të kuptoni ç' vlerë të madhe kanë këndimet për jetën morale dhe materiale të njeriut prandaj sa t'u lejojë koha, përpquni me sa të jetë e mundur, të këndon copat këndimi të zgjedhura, prej të cilavet do të kini fitimin më të math, që ju s'munt ta merrni me ment. Sa u-tha më sipër mbështetet në prova, prandaj mos dyshoni aspak.

Përkthim : Teki Kadilli.

Novelë

Agai në katund.

Mbi Urë të Shkumbinit kalojnë sa e sa kuaj shale, që mbajnë **agallarë**.

Mbi Urë të Shkumbinit udhtojnë me mijë aso krijesash, që mendojnë për bukën e ditës; kalojnë nana këmbëzbathme për t'i blemë një simite djalit të sëmundë; kalojnë pleq, që mendojnë me blemë krypë, kur të shesin një gomar drù; kalojnë gra, që mendojnë të vishen e t'ushqehen, kur të shesin gjelin e detit a pulën, që kanë ngarkue.



Asht një mbramje më se e bukur, ndër ato që mbarim i Gushtit na fal vjetë për vjetë. Vapa mbërzitëse, po edhe aqë begatëse, ka zënë e largohet. Natyra qesh me mallëngjim. Syu kënaqet, zëmra mallëngjehet, shpirti kërkon shpëtim. . . . Me undodhë një këso mbramjeje ndër çajre rreth Urës së Shkumbinit kisha me thënë se asht një sojit me një agim të "Manzarannës", por doemos deri sa shpirti ndies t'i ketë një sojit "përpara", e "mbrapa".

Ura asht madhështore më shumë se e bukur; harqet e 'saj

lânë të kalojnë ndën 'ta valët shkumbuese të lumit plak, që me aqë bukuri mallëngjyese din të përçajë fushat.

Më të djathtë shtrihet një çarje ngushlluese për të mjerët e kënaqëse për të gëzuemit. Drujt e ullijve, që shpërndahen nepër 'të, janë porsí çadra të ngrehuna në kohë vere më ndonji park madhështor.

Kam dalë këndeje me Hysenin, me shokun e valëve të rinis s' ëme. Duem dhe ne, tue u-shmallë, të gjëjmë pushim shpirt- nuer prânë kësaj pamjeje. Hyjmë në çajre. Habitemi: rreth çdo druni truma njerzish: pleq, plaka, burra, grá, fëmij e gjithëshka. Diku ndigjohen kángë **zamâni**, diku të qeshuna, diku kumbon muzika e vëndit, diku përplasen faqore, ndërsa fëmijt mbledhin lule tue rendë. " Vënd lumnije ! „, thashë, "këtu qenka parrajsa, dhe këta njerzit e Perëndis . . . „. Ulemi dhe në prânë një ullini plak rreth rrugës së mädhe, që të çon ke Ura 'Asnjëni s' po e çel gojën. Duket se kënaqsija e shpirtit ka nevojë për heshtje; ajo veç ashtu din të përshkojë fijet má t' imta të ndiesive.

Dielli po ulet mallëngjyeshëm; disa ré të shpërndame me nj' atë harmoni, që din vetë natyra, të vrasin syt me ngjyrën e artë; disa të tjera má nalt, si shpirtnat e shënjtë mbi të tjerët, duken sikur humbin: qielli i kaltërt dhe má nalt, dët i pafund Prân' veç harmoni; fliadi i mbrámjes tund lehtë fletët e ullijve; këto bredhin me hijet e 'tyne të zgjatme; lulet përkulin kryet, përshëndesin diellin; ai zhduket gjithënji, syt mezi shquejnë vëndet, shpirti s' asht me trupin, dhe ja perëndim' i diellit. Atë- here hapim gojën. Çohemi dhe dalim në rrugë. Njerzija nisët për qytet.

Kundrejt nesh ecin tre katundarë; mbas 'tyne një kál i bardhë plot dredhime shkel rrugën; mbi 'të një njeri i madh; pazhdërvjelltija e trupit dhe gjânësija e barkut e bájshin të pas- zotin me qëndrue në kál. Hyseni e përshëndet: "mirë mbrámja, **aga**„, dhe unë báj kështu, se, "kush e din„, thashë. Ai kaloi, dhe atëhere kthehem e pyes shokun :

— Kush ásht ky ? —

— Pse, s' e din ? —

— Jo, i them.

— Asht ai, more, ai që po të njifesh me 'të, s' të njef, po të mos njifesh, të njef.—

Habitem prej kësaj përgjigjeje dhe má fort pse shoku s'asht

i fillosofis, as i enigmave; veç duket se dhe ai ka ndiem një këso të folmeje.

— Fol shqip! — i them — se s'po të marr vesht. — Ai qesh, pse, si duket, i ngjajti si ndonji prej atyne fjalëve, që puthin veç buzët e intelektualit, due me thënë “kopliment,„ Mandej më kthehet :

— Nuk e din ti se deri sa s' i ka dalë era njeriut njëfjet për gjithëshka i mirë; por, kur dhe dy fjalë t' i dalin prej goje, të tjerët ia varin trasjen ? ! —

Unë prapë s'po bije për fije; s'dij se ç'dreq pune mendon ai, dhe prandej prapë e pyes:

— More, s'po të marr vesht! —

Ai qesh prapë.

— Çudi, — më thotë, — si u-bâne si katundar i trashë. —

— Më shau, — thashë me vehte. por me një nejëse e për-colla këtë mendim prej vehtes.

— Ja, more shok: ai **agai** është një pasanik i madh; deri sa s'njifesh mirë me t'ë t'atë pret “t'u-ngjattë jetën „, por, kur të të njofi kush jë, ndërron **dyzeni**. —

S'desha t'i flas më për këtë **aga**, por kureshta s'më lënë.

— K i shkante, Hysen? —

— Në katund, more; po ti besoj se e din më; ai ka kush e din sa bujq e sa. —

— Zoti ia faltël, — i them, dhe qeshim.

Ndër kaqë kemi mbërrimë pranë “Bashkis,„; kthejmë djathtas në rrugën e madhe dhe për pak jemi ke “Posta,„; mändej prapë djathtas, rrugës së Sportit. Të dy kemi kalue njëzet prandverat e jetës, por rrojmë veç nën hijen e rinis; kurrë s'na shkon ndër mënd e ardhmja. Tue ecë andej diçka më thotë diçka i them, një lule shofim, dy zëmra hovin, dy shpirtna tronditen, dhe asgjë t'jetër.

— Hysen, — i them, — po si s'po mundesh me u-martue?

Ah, more vëlla ! atje, ku due unë, s'bàhet.

— Pse? —

— Pse s'kam as kâl shale, as bujq dhe asgja, veç copës së bukës; mändej len e më që gjela deti e vë s'na sjell njeri?! . . .

Unë s'flas, se e pashë që u-ndez, i mjeri, jo për t'jetër, veç prej valëve të rinis. Heshti pak dhe mandej:

— A e pé dje atë katundësin, që pyete, si t'u përgjegji? —

— Po—

— Ai (y gjelat e shportën me vë i çonte në shtëpi t'atij **agait**, që takuem afër urës.... —

— Mirë,— i them,— kush punoftë Zoti i dhântë!—



Agai kalon mbi Urë të Shkumbinit. I merren mëndt. Thërrret katundarët shërbëtorë; ata e mbajnë për krahësh; djersët i shkojnë ujë. Dalin përtej, dhe për një herë:

— Zenel?—

— Urdhëno, **aga**.—

— Ku e ke shtimë faqoren?—

Zeneli kërkon në hebet, që ishin mvarrë mbrapa shalës; e gjëjnë.

— Urdhëno, aga.— dhe ia ep.

E thith me një atë furi, që kishte me thithë një i etshëm pikën e ujit, ndër sa Shabani, katundari t'jetër, i nxjerr në letër një kofshë gjeli të pjekun. Merr pak meze, dhe ja, i erdhi shpirti.

— Tash,— thotë,— do t'ecim për filladi; katundi s'asht larg; sonde do t'ia shtrojmë ke Selmani.—

— Duhet t'ecim pak, **aga**.— i thotë njeni ndër shërbëtorët,
— jemi vonë, më duket.—

— Jo, more Sâl, se kështu njëfet burrnija e atij; — dhe ngrifet mbi kâl, por dhe druen se mos rrëxohet.

Agai ka taktikë të bukur në t'inspektuem të bujqëvet. Ai u shkon pa lajmue dhe plot në mbrâmje. Kujtoj se, po të mos i dhimbesh shpirti më shumë se çdokujt, kishte me u shkue dhe natën.

Ecin gjithënjë. Bukurit e mbrâmjes për ata s'janë gjâ. Katundësit mendojnë vucjtjet e jetës, ndër sa **agai** qysh do t'a gjiejë bujkun, qysh do t'a presë ai,

— Zenel, nep—ma dhe një herë faqoren!—

Duhet mbajtur mënd se shkollat nuk janë vetëm për t'edukuar popullin për hatër t'edukatës, por janë edhe për të nxjerrë prodhonjës sendesh.

Prof. S. Drapper

Thith dhe një herë m'atë ujë të bekuem; **mezja** i rrin prânë, dhe kënaqet.

Ndër kaqë më i ishin afrue katundit. Atëhere **agai** ngrifet mbi kál; shtërngon frenin, përdredh musteqët, ndreq qeleshën e zezë, fshinë me duer qaforen e palltos, lëmon vetullat, dhe ja, **tamam** simpathik.

Mbërrijnë ke kroi në fund të katundit. "Agai, ia bájne nusët e vajzat, që po mbushshijn ujë. Ulën shamijat në shëj turpi, largojnë bolirat dhe largohen dhe vet Ai çon kalin ke kroni, por dhe këtë don t'a mësojë "luks,; nuk e lënë me pimë ujë në govatë, por ia drejton kryet për në lug të kroit:

Agai është madhështor; të rejat e lakmojnë, por porsi një andërr t'ambël në një natë të gjatë, që e nesërmja e kthen në një melankoli të shpirtit. Ai i shef. ato e shofin me bisht të syut ndën sqepin e shámis. Turpënohen ndër vedi prej këmbëvet të zbathuna e prej njollave të baltës, që u kishte lënë puna e ditës. Dhe ato mendojnë diçka; mándej skuqen ndër fëtyra.

Vajza e madhe e bujkut t'agait kishte ndodhë ke kroi. Tronditet e mjera. Le t'a mendojmë së bashku me kënduesin shka ndiente shpirti i 'saj. . . . Ja lënë bolirën njëj shoqes dhe ikën shpejt përpara.

Agai nisët drejt shtëpis së bujkut. Do të ndërrojnë dhe mjaft hapa për të mbërrimë atje.

— Çudi, more **jahu**, me këto katundaret, sa të shëndoshal Gjithë ditën punojnë; rrojnë si është më keq, dhe ja, janë të kuqe si molla; gratë t'ona i ka marrë dreqi.—

— Asht ujët, **aga**, — ia bân njëni prej katundarëvet, — asht ujët.—

Ndër kaqë mbërrijnë ke shtëpija e Selmanit. Pa zbritë **agai** prej kalit bujku i del përpara. I bân me mijna përulje, lutje e të tjera, që veç fjala **temenâ** i mbledh të gjitha. Por **agai** tash është shumë serioz; flet rrallë dhe rëndë. . . . Mándej e ndihmojnë të zbresi prej kalit: kush i mban krahun, kush kambën e kush kalin; një t'jetër ul hebet e faqoren.

— Shif, Selman kalit të m'ia vëshë mendën mirë; ti më e din se si është mësue ky!—

— Si urdhënon, **aga**, si urdhënon.—

Mándej, tne bâmë i mjeri bujk gjithë ato përulie, që veç nevoja ia mëson njeriut. u lutet të hyjnë mbrenda. Futen, por

kaçollja e kashtës s'mund të bëhej vënd kënaqsije për këtë **aga**. I mjeri Selman kishte shtrur një mbi një gjithë teshat e shtëpisë, por se shka se për **agan** ato ishin të ndyeta dhe pa të keq i **kthehet**:

— Ore, shif, a janë të pastra këto rrobe?—

— Po, **aga**, tashti i kemi lamë.—

Si rrafshohen, Selman bujku gjunjëzohet në fund të kthinës dhe e pyet **agán** si është zakona; por, doemos, ky e kishte për turp t'ia kthente përshëndetjen.

Nuk zgjati shumë më e nisi loja e vjetër. Për një t'jetër do t'ishite çudi, por Selmani me shokë ishin mësue.

— Selman, shif,— dhe toni është i egër,— do të na gjëjsh raki të mirë; ti e din se si e pij unë; pakëz e kemi; do të na pjekish dy gjela në tëlynë, do të na bëjsh pak hallvë, bukë gruni, pak djathë të njomë, disa vë të zieme, mollë, arra e pemë çka të keshë; po shif, gjellët i duem të pastra' se ju, jo vetëm që s'dini me bënë gjellë, po jeni dhe **pisa**. Hajt pra; shpejt!— Veç **peqe aga** duhet me pasë në gojë doemos. Dhe Selmani është i mësuem.

— **Peqe, aga, peqe**, si t'urdhënojsh,— dhe del.

Në shtëpi trazim i madh: grueja s'din ku ka lënë shamin e kokës; sillet, përsillet; kërkon një ënë, kërkon një send t'jetër. Burri s'është ndër mend; s'din ç'turdhënojë më para. Fëmijët të trazuem, të habitun, të trembun; dhe këto krijesa e mësojnë këtë frigë në njomsi të jetës. . . .

Burr, o Selman! Shpejt zbrit në burg; dy gjela për fyti, i pret; urdhënon gruen për shpejti në çdo punë. Por ja: djali i vogël, që i kulloste, kishte shumë merak në 'ta dhe ia nisi vajit. Nji shqelm prej t'atit, nji shpullë prej s'amës dhe ja, jashta derës. Mbas 'tij dhe nji vajzë e vogël nis e qanë; ia bëjnë si të parit. Për drejt kishin dhe mjaft fëmijë!. Shpejt mandej qypi me tëlynë të kursuem gjithë verës prej gojës së fëmijës ndodhet mbi zjarr.

— Burr, sheqer s'kemi.—

— Dhe raki hiç,— ia bënë ai. **Dyqan** në katund s'ka. Del me vrap, rëndën ke njëni, s'ka gjë, rëndën ke nji t'jetër, po ashtu; s'dij sa shtëpia kërkon. . . . Kthehet me shpirt ndër hundë; djersët i kullojnë. Mandej rakën me njënjë dorë, disa arra në nji pjatë në dorën t'jetër, disa mollë, pak djathë dhe futet mbrënda.

— Më fal, **aga, aman'** se u vonova —

— Po shpejt de! Ku rrin?! — Provon rakin dhe mândej;

— shpejt ke kalil—

Vrap Selmani; ushqen kalin, e kruen, e lëmon dhe s'dij se ç'bân t'jetër. Kthehet ke grueja Fëmijit qajnë, ai bërtet, grueja kërcet e kush e din mâ. Shpejt prapë ke **agai**

— More, ç'janë këta këlysh dreqnish, që na çanë kokën?, shif dhe pusho-i!—

— **Peqe, aga.**— dhe s'ka t'jetër

Vrap, o Selmani; ke shtëpija. I tmeron fëmijit. Pushojnë Gjelat piqu e fërgohen, hallva fillohet, **agai** turbullohet. Trazim. Prapë ke **agai**. S'e zënë vëndi më vënd të mjerin!

Koka e zotnis rrumbullohet me ujë të bekuem. Nji mijë të shame. Asgjâ s'pëlqehet; kurrgjâ s'kursethet. Disa këngë kumbojnë, disa fëmijë cingërojnë dhe ja, **agai** në katund

Nata kalon. Fëmijit flëjnë për toke; nâna s ka gjum, baba s'âsht ndër mënd.



Agai sa po mbaronte kafën e mëngjezit. Gojë më gojë âsht përhapë fjala: "Agai në katund". Nji grumbull katundarësh mbëlidhen ke Selmani; të shumtët kanë frigë të futen mbrenda. Mândej hyjnë të gjithë dhe gjunjëzohen ne fund të kthinës. Vetëm me urdhën t'atij mund të rrafshohen. Seicili mundohet të dredhij me mjeshtri të duervet t'ashpra nji cingare duhani për **agân**. E pyesin si âsht e si shkon, e ai mezi përgjigjet . . .

Mbërrinë koha e inspektimit: dalin përjashta. Ai ecën përpara, e ata pesë hapa mbrapa. Rreth aravet, kopshteve, livadheve; ke lopët, delet, pulat e gjelat. Nji mijë të shame, nji mijë porosi; kështu këjo, kështu ajo, dhe për ditën e pazarit nji mijë të tjera: duhen vé e gjela për në shtëpi t'**agait**.

Lavdi i qoftë Zotit për Selmanin! Nji t'jetër e priste rrebeshi i drekës.



Prapë lavdi i qoftë të Madhit Zot! Dy herë me e pritë **agân** në vjet Selmani me shokë duhet për motmot të mos shofin kafe, sheqer, tëlynë, ndriçim nate, këmishë të ré e gjithë ato gjâna, që me djersën e zhegut të verës ai mund t'ia sigurojë vehtes aqë kursyeshëm.

Unë s'dij mâ në se **agai** ka shkue prapë ke Selmani i ëm, por, në mos pastë shkue, do të shkojë sigurisht kah prândvera. . .

S. Alliu '33.

Nëna Shqipëtare

(Adaptim nga " Marie de Valandré. „)

I

Fush' e gjërë mbytej në mjergull dhjetori...
Ish mbrëmj' e betejës, që shëmbi, dërmoi;
Kush di sa dëshmorë pa mëshirë i korri,
Mbi tokën e lagur, në t' errët i shtroi!...

Rrëké vajti gjaku... I kuq rrodhi lumi...
Shqiptarisht luftuan dhe ranë në vënt!
E tani, të qetë, përherë i zu gjumi,
Kufoma të shënjta, pa zëmër, pa mënt!...

Rranë!... Dhe s' kursyen shtëpi, plëng, fëmijë...
Vdiqën krye-lartë, heronj t' kombit mbarë!
Për mëmën luftuan, dhe ranë me mijë,
Në fushën e nderit, atje patnë varrë!...

II

Natë!... Hën' e zbetë rend nër vala rësh...
Me sy të tmeruar, vështron e mahnitur
Me mijra të vdekursh, të shtrirë në shesh
Fytyrë zbuluar, me sy të venitur.

Drejt fushës së vdekjes, hordhi ngjyrë sterrë,
Zoq të zes si Ferri derdhen me shëmtim;
Futin sqep' n e 'tyre në krahor' e çjerrë,
Çukitin gëzuar syt e ushtarit trim!...

Natë!... Hën' e zbetë rend nër vala rësh...
Nëna ditë-zezë kërkon bir e vrarë,
E unjet, e ngrihet, vëren si e marrë
Sa gjen, rëzë lehës, bir e 'saj që desh!...

Dhe e pá të shtrirë përmes baltovinës...
Flamurin përsipër si savan kish vënë...
— Hën' e llahtaritur zu të shdukej tinës —
Nëna s' qau: S' qahet' mbi heronjt' e rënë!

Puthi dhëmshurisht të dy syt' e djalit;
I mori flamurin nga dora e ngrirë;
E zu, tu' u-dredhur, të ngjitej lart malit,
Në kampin e " Shqipes „ sosi më të gdhirë...

— Më fal, **aga, aman'** se u-vonova —

— Po shpejt de! Ku rrin?!— Provon rakin dhe mändej:

— shpejt ke kali!—

Vrap Selmani; ushqen kalin, e kruen, e lëmon dhe s'dij se ç'bân t'jetër. Kthehet ke grueja Fëmijit qajnë, ai bërtet, grueja kërcet e kush e din mâ. Shpejt prapë ke **agai**

— More, ç'janë këta këlysh dreqnish, që na çanë kokën?, shif dhe pusho-i!—

— **Peqe, aga.**— dhe s'ka t'jetër:

Vrap, o Selman!; ke shtëpija. I tmeron fëmijit. Pushojnë Gjelat piqen e fërgohen, hallva fillohet, **agai** turbullohet. Tra-zim. Prapë ke **agai**. S'e zënë vëndi më vënd të mjerin!

Koka e zotnis rrumbullohet me ujë të bekuem. Nji mijë të shame. Asgjë s'pëlqehet; kurrgjë s'kursehet. Disa këngë kumbojnë, disa fëmijë cingërojnë dhe ja, **agai** në katund

Nata kalon. Fëmijit flëjnë për toke; nâna s'ka gjum, baba s'është ndër mënd.



Agai sa po mbaronte kafën e mëngjezit. Gojë më gojë është përhapë fjala: "Agai në katund, . . . Nji grumbull katundarësh mbëlidhen ke Selmani; të shumtët kanë frigë të futen mbrenda. Mändej hyjnë të gjithë dhe gjunjëzohen ne fund të kthinës. Vetëm me urdhën t'atij mund të rrafshohen. Seicili mundohet të dredhij me mjeshtëri të duervet t'ashpra nji cingare duhani për **agân**. E pyesin si është e si shkon, e ai mezi përgjigjet . . .

Mbërrinë koha e inspektimit: dalin përjashta. Ai ecën përpara, e ata pesë hapa mbrapa. Rreth aravet, kopshteve, livadheve; ke lopët, delet, pulat e gjelat. Nji mijë të shame, nji mijë porosi; kështu këjo, kështu ajo, dhe për ditën e pazarit nji mijë të tjera: duhen vé e gjela për në shtëpi t'**agait**.

Lavdi i goftë Zotit për Selmanin! Nji t'jetër e priste rrebe-shi i drekës



Prapë lavdi i goftë të Madhit Zot! Dy herë me e pritë **agân** në vjet Selmani me shokë duhet për motmot të mos shofin kafe, sheqer, tëlynë, ndriçim nate, këmishë të ré e gjithë ato gjâna, që me djersën e zhegut të verës ai mund t'ia sigurojë vehtes aqë kursyeshëm.

Unë s'dij mâ në se **agai** ka shkue prapë ke Selmani i êm, por, në mos pastë shkue, do të shkojë sigurisht kah prândvera. . .

S. Alliu '33.

Nëna Shqipëtare

(Adaptim nga " Marie de Valandrë. „)

I

Fush' e gjërë mbytej në mjergull dhjetori...
Ish mbrëmj' e betejës, që shëmbi, dërmoi;
Kush di sa dëshmorë pa mëshirë i korri,
Mbi tokën e lagur, në t' errët i shtroi!...

Rrëké vajti gjaku... I kuq rrodhi lumi...
Shqiptarisht luftuan dhe ranë në vënt!
E tani, të qetë, përherë i zu gjumi,
Kufoma të shënjtja, pa zëmër, pa mënt!...

Rranë!... Dhe s' kursyen shtëpi, plëng, fëmijë...
Vdiqën krye-lartë, heronj t' kombit mbarë!
Për mëmën luftuan, dhe ranë me mijë,
Në fushën e nderit, atje patnë varrë!...

II

Natë!... Hën' e zbetë rend nër vala rësh...
Me sy të tmeruar, vështroton e mahnitur
Me mijra të vdekursh, të shtrirë në shesh
Fytyrë zbuluar, me sy të venitur.

Drejt fushës së vdekjes, hordhi ngjyrë sterrë,
Zoq të zes si Ferri derdhen me shëmtim;
Futin sqep' n e 'tyre në krahor' e çjerrë,
Çukitin gëzuar syt e ushtarit trim!...

Natë!... Hën' e zbetë rend nër vala rësh...
Nëna ditë-zezë kërkon bir e vvarë,
E unjet, e ngrihet, vëren si e marrë
Sa gjën, rëzë lehës, bir e 'saj që desh!...

Dhe e pá të shtrirë përmes baltovinës...
Flamurin përsipër si savan kish vënë...
— Hën' e llahtaritur zu të shdukej tinës —
Nëna s' qau: S' qahet' mbi heronjt' e rënë!

Puthi dhëmshurisht të dy syt' e djalit;
I mori flamurin nga dora e ngrirë;
E zu, tu' u-dredhur, të ngjitej lart malit,
Në kampin e " Shqipes „, sosi më të gdhirë...

“ Ja „ i tha “ të Parit „ “ një flamur të shtrënjtë
 Ja mora t’ im biri të vdekur, or miq! „
 E si ngjiti buzët mbi cohën e shënjtë,
 U-verdh përnjëherësh ... e ra pa zë ... vdiq! ...

Sotir Caci

Vizatimet e penës

“ Tabloja e një vëndi „

Kushtuar shokut t’ im : P. N.

Dikur ndodhej një fushë e vogël, ndërmyet dy shkëmbijsh madhështorë, nën të cilët binte një humnerë e thellë. Gjatë aqë shekujve elementi shkatërrues, uji, gërru thellë e pa mëshirë, palat e tokës fushore, ngjer sa harriji në gjëndjen e sotme: në fundin e ‘saj.

... Sot dy shkëmbinj të gjigandë, ngrihen madhështorë mbi humnerën, duke u-rrahur prej ujit që shkumzohet atje poshtë ...

... Nga fundi i humnerës del një melodi, melodia e përzjerë e humnerës. Lart, mbi trikëndëshin e vogël të fushës, i cili formohet nga rrjedhjet e ujit, ngrihet një bregore dhe mbi ‘të një dumbre lisash nënë të cilët shlodhet heroi i një populli, i cili e ngriti atë nga humnera që po binte: “ Nga rrobërija shekullore „ ...

Në një udhë gjarpërore, e cila shkon nën varrin e heroit, si milingonat e dheut shkojnë e vijnë qindra veta, që rrojnë për shoqërinë dhe jetën. Ideali i tyre është puna, e shkuara, një shkuarë prallore, që nuk flitet më, pse vëndin e saj e zuri e ardhmja plot shpresa.

Në njerën anë të humnerës, larg ‘saj, ngrihet shkolla, ku dikush, nga gjiri i atij populli, predikon, mbi filizat e njomë, jo parime që bazohen mbi të shkuarën e hidhur, por gjëra të thjeshta, që shtyjnë popujt drejt punës. Puna mbush me kënaqësi, shpirtin e secilit.

Siç është skulptura për një gur mermeri,
 ashtu është arsimi për trurin e njeriut.

Addison

Punën e predikojnë traditat gojore dhe fjalët e urta t' atij heroi, puna i mban lart mbi humnerë, kurse e përkundërta i dërgon në fundin e 'saj.....

.... Dhe seicili punon, punon për një ideal; zhurma e punës që përhapet më çdo anë, është shënja e gjallë e 'saj, për harritjen drejt atij.



Pak nga pak, dielli perëndon, muzgu bie mbi tokë; njerzit e punës, që punojnë pa pushuar për aqë orë, tani po çlodhen qetësisht, duke ndërjet të ngrihet në fundin e zëmres së 'tyre kënaqësija m' e madhe: kënaqësija e punës.

Hëna lëshon plot madhëri rrezet e 'saj, të cilat mbrujnë në qetësinë e natës një jetë të re. Nga fundi i humnerës del melodia e 'saj, nga arat e punuara del melodia e punës, nga lumi gurgullonjës, atje poshtë, melodia monotone; Hëna shtegtare, vjedhësja e bukurive, hynë lehtë e lehtë në kasollet e qeta, duke vjedhur: lumturinë, bukurinë, vllëzërinë, drejtësinë, dëshirën e punës, të cilat, n' errësirën e natës, bashkohen duke formuar pemën më madhështore të natës, e cila duke u-veshur me përrallat dhe kallëzimet e kohës së kaluar formon: frikën që shpërndan nata.....

.... Dhe fshati, ai i kolos i heshtur, i tulitur mbi truallin e 'tij vren çdo gjë; çdo gjë e së kaluarës lë gërvishjet e 'saj mbi të, për të treguar qenëjen e 'saj.

Koço Papaproko

V. D. V. '38.

Folklorë.

Fjalë të qëmtueme në Tomoricë

prej Normalistit Azem Teferiçit.

1. Telikë-a = kular (i parmendës)
2. Qabushinë-a = një copë postiqe e ndrequn si jostik, që përdoret për qafën e kaut, kur lëron.
3. Dinçkë-a = macurr, kacarrum (misri)
4. Fytak-u = jebrig.
5. Vedër-a = kade e vogël.

6. Shejgë-a = kade mâ e vogël se vedra
7. Kade-ja = mti i math e i gjanë
8. Rondije = parmenda bashkë me zgjedhën
9. Killoçkat a loçkat = kokërdhokët (e synit)
10. Me pushtue = me përqaful
11. Spicë-a = maja e pendës
12. Karçin = keç motak, ftujkë
13. Msallë-a = përparse, përparje, barkore
14. Prokovaç-i = qylym në vend të hasrës
15. Pisërvagë-a = një shtazë si zhapini me pika të verdha në shpinë dhe me gojë si bretkosa
16. Burrall-i = bullari
17. Fërtomë-a = litar
18. Buzë-delje = një lule e bardhë me 5-6 fletë në formë të terfilit
19. Mashabigë-a = kacija
20. Ponice-a = çerep prej balte
21. Krahe = bërzore, këmisha e linjtë, mangore
22. Kafit (qeni). kur ka ra n' erë të leprit ose të ndonji shtaze a shpeze tjetër dhe lef
23. Me pushtue = me përqaful
24. Topila = një hurdhë e madhe, ku qëndron ujët për me ujët
25. Pelleng-u, pellengje-t = hurdha të vogla.
(vijon)

Lajmet e Shkollës.

Më 3 të këtij muaji u-zhvilluan disa ndeshje sportive midis shkollës s' onë, dhe Gjinnazit të Tiranës. Lojnat që u-bënë muarnë fund si vijon: Në Foot-ball barazuan 0 — 0 Në Basket-ball 14 — 14, ndeshjen e Voley-ballit e fitoi Gjinnazi me 2 — 1.

Më 7 Maj, Z. Ali Miftiu, mësues n' Ushtrimoren e shkollës s' onë, celebroi martesën e 'tij. " Normalisti „ i Uron çiftit të ri jetë të lumtur dhe fat-bardhë.

Më 10 të Majit lojtarët e shkollës s' onë, shkuan në Tiranë për të bërë " revanche-in „ e ndeshjeve të shvilluara në qytetin t' onë më 3 të këtij muaji.

Këto ditë urdhëroi në shkollën t' onë Z. Sotir Kozmo, profesor i Muzikës. Zotria e 'tij u transferua nga Liceu Kombëtar i Korçës, në shkollën t' onë.

Me iniciativën e profesorit të Histori Natyrës Z. Dr. Stilian Gaxho, klasa e fundit, më 27 të këtij muaji, bëri një shëtitje, me qëllim edukativ, jashtë Elbasanit. Mori pjesë në këtë shëtitje dhe prof. i Bujqësis Z. Ing. Agr. Vasil Stralla bashkë me prof. e Kimis Z. Kol Popa. Profesori i H. Natyrës Z. Dr. Gaxho, në vëndet që shetitën, u spjegoi nxënësve shkurt periudhat e ndryshme të formimit gjeologjik të tokës Shqiptare. U tregoi fosilet e guaskave të detit dhe u foli mbi ç'na japin të kuptojmë ato fosile përsa i përket gjendjes së moçme gjeologjike të Shqipris.

Ate ditë u-mësuan dhe shumë gjëra të tjera, që interesojnë drejt për së drejti mësonjësin; ndër këto mund të përmëndim: mënyrën e mbledhjes së insekteve të ndryshme dhe përmbajtjen e tyre, për të formuar koleksione gjithëfajësh. Bashkë me këtë "studim në natyrë", nxënësit kaluan pak orë dëfrimi në mes të larmisë së luleve, cicërimit të zogjve, dhe duke kundruar gjelbërimin e plotë të vëndit, për të cilin çquhet natyra e jashtme e Elbasanit.

Vitin e kaluar, kur u-dogj Drejtoria e shkollës s' onë, u dogjën dhe koleksionet e "Normalistit". Mungesa e një koleksionit, të paktën, është një e metë e madhe. Për këtë arsye na kemi filluar të mbledhim numëra të vjetër me qëllim që të gjejmë një kopje për çdo numër, që ka dalë deri më sot në mënyrë që të formohet një koleksion i plotë. Janë të lutur ata mësonjës ose nxënës "Normalistë", që, në qoftë se kanë numra të vjetër të së përkohshmes s' onë, të na i dërgojnë, ne se atyre nuk u hyjnë në punë. Do t' i sjellin një shërbim të math "Normalistit", dhe për këte do t' u-jemi mirënjohës.

V. R. Kundër dëshirës s' onë ky numër del pa as një provë mësimit. Faji nuk është i yni; arësytën ua kemi treguar me kohë këndonjësvet. Klasa e fundit nuk jep në Ushtrimore këte vit shkollor, prandaj ndeshim vështirësira në gjetjen e provave. Jemi në gjendje të çmojmë vlerën e provave të mësimit, mirpo kur s' kemi se ç' të bejmë... s' na mbetet veçse të kërkojmë ndjesë këndonjësvet për këte të metë me gjithë që është, siç e thamë në fillim, kundër dëshirës s' onë.

Ndreqje gabimesh.

Në faqen 27, në Folklorë, gabimisht është shkruar fjala dinçkë-a në vend të fjalës druçkë-a.

Gjithashtu fjala nr. 15 duhet të jetë pisëragë-a dhe jo pisërvagë-a.

**V. B. Numër' i fundit, për këtë vit
shkollor, do të qarkullojë më 20 të
Qershorit.**
